



HASHIM THAÇI PO KA VËSHTIRËSI FINANCIARE PËR TA PAGUAR EKIPIN MBROJTËS

THAÇI MBETET PA AVOKATIN KRYESOR GREGORY KEHOE, SHKAK VËSHTIRËSITË FINANCIARE



Avokatët kryesorë të mbrojtjes së Hashim Thaçit pranë Dhomave të Specializuara në Hagë, Gregory Kehoe, Joe Reeder, "Greenberg Legal Associates" dhe anëtarët e kësaj kompanie, kanë kërkuar të tërhiqen në rastin e tij në Gjykatën Speciale në Hagë. Në kërkesën e tyre ndaj Dhomave të

Specializuara në Hagë është përmendur moskryerja e obligimeve ndaj tyre. Ndërkaq Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se ka realizuar me kohë të gjitha pagesat dhe obligimet për mbrojtjen e Hashim Thaçit, duke iu referuar marrëveshjes që ka vetëm me avokatin mbrojtës të

Hashim Thaçit, Luka Misetić. Vëllai i ish-presidentit Thaçi, Idriz Thaçi, duke e falënderuar avokatin Kehoe dhe ekipin e tij për angazhimin e deritashëm, ka sqaruar se kontrata me kompaninë ligjore "Greenberg Legal Associates" nuk është vazhduar për shkak të vështirësive financiare

"ÇLIRIMTARËT PA MBROJTJE NË GJYKATËN SPECIALE, KURTI DHE QEVERIA HESHTIN" F. 5



OSMANI TAKON LAJÇAKUN: I VETMI INSTITUCION QË MUND TA INTERPRETOJË ASOCIACIONIN ËSHTË KUSHTETUESJA F. 5



AKTUALE



BRITANIA E MADHE PO E SHOYRTON NJOHJEN E SHTETIT PALESTINEZ F. 2

POLICIA THOTË SE THASËT ME RËRË QË U GJETËN NË ZVEÇAN ISHIN PËRDORUR NË BARRIKADA F. 7

JASHARAJ KËRKON DEBAT PËR ARSIMIN NË KOSOVË F. 7

EKONOMI



ATK-ja NDRYSHON PROCEDURAT PËR PAJISJE ME VËRTETIM TATIMOR F. 8

IMPORTET E KOSOVËS NGA SHTETET CEFTA-S NË DHJETOR ARRITËN NJË VLERË PREJ 69,1 MILIONË EUROSH F. 8

SPORT



KOSOVA ORGANIZON DY KAMPIONATE EVROPIANE, SARAÇINI: ARRITJE E MADHE PËR FHK-në F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbl: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Britania e Madhe po e shqyrton njohjen e shtetit palestinez

LONDËR, 30 JANAR - Britania e Madhe është e gatshme ta njohë formalisht një shtet palestinez, ka lënë të kuptohet të martën sekretari i Jashtëm David Cameron.

Cameron theksoi se palestinezëve duhet t'u jepet një horizont politik për ta nxitur arritjen e paqes në Lindjen e Mesme.

Britania e Madhe e ka përgjegjësinë ta paraqesë se si do të dukej një shtet palestinez, sipas tij.

Popullit palestinez duhet t'i shfaqet "përparim i pakthyeshem" drejt një zgjidhje me dy shtete, shtoi ai. "Derisa kjo ndodh, ne bashkë me aleatët do ta konsiderojmë njohjen e një shteti palestinez, përfshirë edhe në Kombet e Bashkuara", tha ai në Këshillin Konservator për Lindjen e Mesme. "Kjo mund të

jetë një nga gjërat që ndihmojnë ta bëjë këtë proces të pakthyeshem", tha i.

Ai i bëri thirrje Izraelit të lejojë më shumë ndihma ndërkombëtare në Rripin e Gazës dhe e cilësoi "qesharake" kthimin mbrapsht të ndihmave jetike britanike dhe ndihmave të tjera në kufi.

Cameroni theksoi se 30 vjetet e fundit kanë qenë histori dështimi për Izraelin për shkak se ka dështuar të ofrojë siguri për qytetarët e vet.

Vetëm duke e pranuar këtë dështim, shtoi ai, do të ketë paqe dhe përparim.

Britania ka kohë të gjatë që e mbështet një zgjidhje me dy shtete, ku izraelitët dhe palestinezët mund të jetojnë krah për krah në vende të ndara. Por, Cameroni sugjeroi se Britania mund t'i ofrojë njohje



formale dhe diplomatike një shteti palestinez, jo si pjesë e një marrëveshjeje finale për paqe, por më herët, gjatë bisedimeve. Në të njëjtën kohë duhet të ketë

edhe një autoritetet të ri palestinez me "liderë të mirë dhe teknokratikë" që janë në gjendje ta udhëheqin Gazën, nënvizoi ai. Në lidhje me përpjekjet për t'i

dhënë fund luftës së Izraelit në Gazë, Cameroni tha se ndërprerja e luftimeve është e nevojshme tani dhe se ka "shenja shpresëdhënëse" për bisedimet që po zhvillohen. "Tani po shohim hapjen e një ruge ku ne mund të shënojmë përparim vërtet jo vetëm për t'i dhënë fund konfliktit, por përparim në gjetjen e një zgjidhjeje politike e cila mund të nënkuptojë paqe për vite, e jo për muaj", tha ai. Lufta e Izraelit në Rripin e Gazës e ka shkatërruar shumicën e territorit të vogël dhe i ka vrarë mbi 26 000 palestinezë, sipas Ministrisë palestineze të Shëndetësisë.

Kjo luftë u nxit nga një valë sulmesh të luftëtarëve të Hamasit në Izrael më 7 tetor, ku u vranë rreth 1 300 njerëz dhe u rrëmbyen mbi 250 të tjerë, sipas autoriteteve izraelite.

Putini ia jep Vulinit "Urdhrin e Miqësisë"

MOSKË, 30 JANAR - Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, ka ndarë "Urdhrin e Miqësisë" për ish-drejtorin e Agjencisë serbe të Sigurisë dhe Informacionit (BIA), Aleksandar Vulin.

Lajmi u bë i ditur nga Lëvizja e Socialistëve, që është themeluar nga Vulini.

Sipas njoftimit, Vulini u nderua "për kontributin e madh të dhënë për zhvillimin dhe përmirësimin e bashkëpunimit mes BIA-s dhe Shërbimit të Huaj të Inteligjencës të Rusisë (SVR) në fushën e garantimit të sigurisë shtetërore dhe të mbrojtjes së interesave kombëtare të Serbisë dhe Rusisë". Lëvizja e Socialistëve njoftoi se i dërguari i Putinit, drejtori i Shërbimit të Huaj të Inteligjencës



ruse, Sergei Naryshkin, ia dha urdhrin Vulinit në selinë e këtij shërbimi në Moskë. Naryshkin, sipas njoftimit, tha se Vulini e meriton këtë çmim për

shkak të përpjekjeve të tij të vazhdueshme që synojnë të zhvillojnë raportet ruso-serbe dhe bashkëpunimin e shërbimeve të inteligjencës së

Rusisë dhe Serbisë.

Vulin ka vazhduar të mbajë kontakte të drejtpërdrejta me zyrtarët rusë edhe pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Vetëm dy ditë më parë, Vulin po ashtu u nderua nga drejtori i Shërbimit Federal të Sigurisë së Rusisë, gjenerali i ushtrisë, Alexander Bortnikov.

Bortnikov ia ndau Vulinit urdhrin për profesionalizëm të lartë dhe kontribut në bashkëpunimin midis shërbimeve serbe dhe ruse. Ai këtë urdhrë e pranoi në selinë e këtij shërbimi rus në Moskë më 28 janar.

Vulini për një kohë të gjatë ka qenë partner i koalicionit të presidentit serb, Aleksandar

Vučić, deri së voni sa ishte në krye të BIA-s.

Në korrik të vitit 2023 Shtetet e Bashkuara e futën në listën e sanksioneve nën dyshimet për përfshirje në korrupsion dhe trafikim me drogë, si dhe për lidhje me Rusinë.

Më 3 nëntor 2023 Vulini dha dorëheqje nga udhëheqja e BIA-s, duke argumentuar se ai nuk kishte të drejtë të "sakrifikonte Serbinë" duke qëndruar në këtë post.

Në të kaluarën ai ka mbajtur disa poste politike, nga posti i shefit të Zyrës për Kosovën në Qeverinë serbe e deri tek udhëheqja e dikastereve të mbrojtjes dhe çështjeve të brendshme dhe në fund shërbeu si kryespiun.

Ish-kryeministri pakistanez dënohet me 10 vjet burgim

ISLAMABAD, 30 JANAR - Një gjykatë në Pakistan ka dënuar ish-kryeministrin Imran Khan dhe Shah Mahmood Qureshi, një prej zyrtarëve të lartë të partisë së tij, Pakistan Tehrik-e Insaf (PTI), me dhjetë vjet burgim secilin, pasi ata u gjetën fajtorë për zbulim të sekreteve shtetërore.

Gjykatësi i Gjykatës Speciale, Abul Hasnat Zulqarnain, bëri të ditur vendimin më 30 janar në një seancë të mbajtur brenda burgut Adiala.

Khan, i cili u rrëzua nga pushteti përmes një mocioni mosbesimi në Parlament në prill të vitit 2022, aktualisht është duke vuajtur një dënim prej tre vjetësh burgim për një rast korrupsioni.

Khanit veçse i është ndaluar që të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare të caktuara për 8 shkurt, për shkak të një dënimi

paraprak.

Partia PTI tha se do të sfidojë vendimin dhe tha se ka shpresë që dënimi do të anulohet. "Ne nuk e pranojmë këtë vendim të jashtëligjshëm", tha avokati i Khanit, Naeem Panjutha, përmes një postimi në X, që më herët njihej si Twitter.

Dënimi i fundit vjen pasi Khan kishte zbuluar një dokument konfidencial diplomatik gjatë një tubimi publik, pas rrëzimit të tij nga pushteti më 2022.

Atëbotë, Khan pretendoi se dokumenti, të cilit i ishte referuar me termin "Cipher", ishte dëshmi se rrëzimi i tij ishte orkestruar nga ushtria e fuqishme e Pakistanit në koordinim me Shtetet e Bashkuara. Si ushtria, ashtu edhe Uashingtoni, kishin mohuar këto akuza.

Dokumenti nuk është bërë



publik, por duket se ai përmbante një komunikim të një kabllogrami diplomatik mes

Ambasadës së Pakistanit në Uashington dhe Ministrisë së Jashtme të Pakistanit.

Pavarësisht se i është ndaluar pjesëmarrja në zgjedhjet e ardhshme, Khan 71 vjeç, dhe partia e tij PTI ende gëzojnë popullaritet të madh në Pakistan. Më 21 tetor 2023, ish-kryeministri Nawaz Sharif, që ka mbajtur këtë post për tri mandate dhe që është një rival i kamotshëm i Khanit, u kthye në Pakistan pasi për katër vjet kishte qëndruar në mërgim dhe nisi fushatën zgjedhore me partinë e tij Liga Myslimane e Pakistanit, duke mbajtur një tubim të madh në Lahore.

Partia e Khanit dhe e Sharifit konsiderohen si partitë kryesore në zgjedhjet e ardhshme.

Pakistan, shtet me 241 milionë banorë, është mbërthyer nga një krizë e rëndë ekonomike dhe ka përjetuar rënie të shpejtë të standardit të jetesës.

KDI-ja: Kosova t'i qaset seriozisht luftës kundër korrupsionit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 JANAR - Të martën Transparency International ka publikuar Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit (CPI) për vitin 2023. Indeksi publikohet për 180 shtete të botës, duke përdorur një metodologji vlerësuese e cila është e bazuar në burime kredibile të institucioneve ndërkombëtare. Poentimi bazohet në vlerësim nga zero deri në 100 pikë, ku zero pikë paraqet nivelin më të lartë të korrupsionit, ndërsa 100 pikë do të thotë shoqëri pa korrupsion.

Instituti Demokratik i Kosovës përmes një njoftimi për medie ka bërë me dije se për vitin 2023 Kosova është vlerësuar me 41 pikë, po aq sa ishte vlerësuar në vitin e kaluar, ndërsa zë vendin e 83-të në ranglistën botërore.

Pozitën e 83-të Kosova e ndan me vendet si Burkina Faso, Afrika e Jugut dhe Vietnami. Në krahasim me vendet e Ballkanit Perëndimor, Kosova sivjet renditet e treta, pas Malit të Zi (në vendin e 63) dhe Maqedonisë së Veriut (në vendin 76). Pas Kosovës rezultate më të dobëta kanë Shqipëria (në pozitën 98), Serbia (në pozitën 104) dhe Bosnjë-Hercegovina (në pozitën 108). Është për t'u theksuar fakti se përgjatë 12 viteve prej kur

Kosova është bërë pjesë e vlerësimit të CPI është shënuar progres inkremental prej 7 pikësh, nga 34 pikë në vitin 2012, në 41 pikë në vitin 2023. "Sidoqoftë, progresi i ngadaltë, por i qëndrueshëm i Kosovës në dekadën e fundit, është kryesisht rezultat i progresit demokratik që i atribuohet mbajtjes së zgjedhjeve të lira dhe transferimit paqësor të pushteteve përgjatë viteve. CPI, megjithatë, thekson se ky progres nuk është reflektuar edhe në performancën kundër korrupsionit. Pavarësisht prej përpjekjeve të vazhdueshme, reformat që janë kyçe për pavarësinë dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë – përfshirë procesin e vettingut dhe Ligjin mbi Këshillin Prokurorial, po ecin me ritme shumë të ngadalta. Për më keq, ndërhyrjet e vazhdueshme të qeverisë në çështjet gjyqësore, shkarkimi i udhëheqës të Njësisë së Veçantë të Hetimeve në Policinë e Kosovës, pasuar nga pengimi i hetimit parlamentar për rastin e dyshuar të korrupsionit për rezervat shtetërore nga deputetët e shumicës parlamentare, tregojnë që mungon vullneti politik për të hequr dorë nga kontrollimi i gjyqësorit dhe për ta forcuar mbikëqyrjen e pavarur", ka theksuar KDI.



Sipas KDI-së, në përgjithësi rezultatet e CPI 2023 tregojnë që shumica e vendeve të botës kanë bërë fare pak apo aspak progres në luftimin e korrupsionit në sektorin publik përgjatë dekadës së fundit. "Për më tepër, mbi 2/3 e vendeve, përfshirë edhe Kosovën, vlerësohen me më pak se 50 pikë nga 100 pikët maksimale, indikator ky që tregon për prani serioze të problemeve me

korupsionin. Madje, qytetarët e Kosovës bëjnë pjesë në 80%-shin e popullsisë botërore që jeton në një shtet që është nën mesataren globale prej 43 pikësh. Ekziston një trend global i dobësimit të sistemeve të drejtësisë, që ka reduktuar llogaridhënien e zyrtarëve publikë e për pasojë i ka mundësuar korrupsionit që të lulëzojë. Në mënyrë që të ndërpritet

pandëshkueshmëria e korrupsionit, Transparency International vlerëson që qeveritë duhet t'i garantojnë pavarësinë, resurset dhe transparencën e nevojshme sistemeve të drejtësisë, në mënyrë që të gjitha rastet e korrupsionit të ndëshkohen dhe të garantohet kontrolli dhe bilanci i pushteteve", ka theksuar KDI në njoftimin për medie.

Osmani takon Lajçakun: I vetmi institucion që mund ta interpretojë Asociacionin është Kushtetuesja

EPOKA
ERE

F. DËRMAKU

PRISHTINË, 30 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim përfaqësuesin special të Bashkimit Evropian, Miroslav Lajçak.

Presidenca ka njoftuar se në takim është diskutuar për zhvillimet e fundit në procesin e dialogut me Serbinë, me ç'rast presidentja Osmani ka ritheksuar përkushtimin e Kosovës si palë konstruktive në këtë proces. Presidentja theksoi se marrëveshja e Brukselit e 27 shkurtit 2023 dhe aneksi i Ohrit i 18 marsit 2023 duhet të zbatohen plotësisht. Presidentja Osmani ritheksoi nevojën e heqjes së masave të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës, të cilat janë të padrejta dhe krijojnë mungesë ekuilibri në dialog. Në këtë drejtim ajo përsëriti se Kosova ka ofruar organizimin e

zgjedhjeve të reja në veri të vendit në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, duke miratuar edhe udhëzimin administrativ, ndërkaq theksoi pritet e saj që kjo e drejtë e qytetarëve të realizohet pa vonesa e në përputhje me procedurat dhe legjislacionin në fuqi.

Në këtë takim u përshëndetën të arriturat e fundit sa i përket zbatimit të marrëveshjes për energji si dhe asaj për targa, si hapa drejt normalizimit të raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sa i përket draftit të statutit të Asociacionit, presidentja Osmani ritheksoi se institucioni i vetëm që mund ta interpretojë përfundimisht përputhshmërinë e këtij akti me Kushtetutën është Gjykata Kushtetuese e Kosovës gjersa, po ashtu, i shprehu shqetësimet e saj lidhur me disa dispozita të këtij drafti, të cilat mund të jenë sfiduese gjatë zbatimit në praktikë.

Maqedonci viziton Komandën e Forcave Speciale të Turqisë, teston një snajper

PRISHTINË, 30 JANAR - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka vizituar Komandën e Forcave Speciale Turke. Ai është pritur në takim nga Komandanti i Forcave Speciale, gjeneral Omer Ertugrul Erbakan. "Kisha kënaqësinë që sot të vizitoj Komandën e Forcave Speciale Turke, me ç'rast u pritë në takim nga Komandanti i

Forcave Speciale, gjeneral Omer Ertugrul Erbakan. Në një kohë kur bota po përballet me kërcënime të natyrës hibride, njësitë jokonvencionale si Forcat Speciale përbëjnë kapacitetet të rëndësishëm. Gjatë takimit me komandant Erbakan diskutuam rreth programeve trajnuese të Forcave Speciale Turke që

mund të ndjekin ushtarakët e Forcës Speciale të FSK-së. Komandantin e falënderova për mbështetjen e deritanishme, ndërsa u dakorduam për të vazhduar bashkëpunimin me qëllim avancimin e kapaciteteve profesionale të FSK-së", ka shkruar Maqedonci në "Facebook".





HASHIM THAÇI PO KA VËSHTIRËSI FINANCIARE PËR TA PAGUAR EKIPIN MBROJTËS

Thaçi mbetet pa avokatin kryesor Gregory Kehoe, shkak vështirësitë financiare

Avokatët kryesorë të mbrojtjes së Hashim Thaçit pranë Dhomave të Specializuara në Hagë, Gregory Kehoe, Joe Reeder, “Greenberg Legal Associates” dhe anëtarët e kësaj kompanie, kanë kërkuar të tërhiqen në rastin e tij në Gjykatën Speciale në Hagë. Në kërkesën e tyre ndaj Dhomave të Specializuara në Hagë është përmendur moskryerja e obligimeve ndaj tyre. Ndërkaq Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se ka realizuar me kohë të gjitha pagesat dhe obligimet për mbrojtjen e Hashim Thaçit, duke iu referuar marrëveshjes që ka vetëm me avokatin mbrojtës të Hashim Thaçit, Luka Misetić. Vëllai i ish-presidentit Thaçi, Idriz Thaçi, duke e falënderuar avokatin Kehoe dhe ekipin e tij për angazhimin e deritashëm, ka sqaruar se kontrata me kompaninë ligjore “Greenberg Legal Associates” nuk është vazhduar për shkak të vështirësive financiare

arsyeshëm se do të kërkonin përfundimi nëse nuk u është përmbushur detyrimi”, është thënë në kërkesën e tyre, duke u sqaruar detajet shtesë se si mund të vazhdohet mbrojtja e Thaçit në Hagë. “Në bazë të nenit 21(4)(e) të Ligjit Nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Prokuroria e Specializuar (‘Ligji’), z. Thaçi ka të drejtë të mbrohet përmes një avokati specialist të zgjedhur prej tij; të informohet, nëse ai ose ajo nuk e bën këtë, të ketë ndihmë juridike për këtë të drejtë; dhe t’i caktohet një Këshilltar Special ose atë, në çdo rast kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë dhe pa pagesë prej tij, ose ajo në çdo rast të tillë nëse ai ose ajo nuk ka mjete të mjaftueshme për të paguar për të”, është thënë në këtë kërkesë.

Në një prononcim për medie, vëllai i ish-presidentit Thaçi, Idriz Thaçi, duke e falënderuar avokatin Kehoe dhe ekipin e tij për angazhimin e deritashëm, ka sqaruar se kontrata me

kompaninë ligjore “Greenberg Legal Associates” nuk është vazhduar në vitin 2024 për shkak të vështirësive financiare në mbulimin e kostos së të gjithë avokatëve të angazhuar si pjesë e mbrojtjes së Thaçit. Avokat kryesor i Thaçit tani e tutje do të jetë avokati i njohur me prejardhje kroate, Luka Misetić.

Vëllai i ish-presidentit Thaçi ka shprehur besimin se ekipi aktual do të vazhdojë me përkushtim të plotë mbrojtjen dinjitoze dhe në fund të këtij procesi do të dëshmohej pastërtia dhe e vërteta e luftës së UÇK-së. “Në pamundësi për ta mbuluar koston për të gjithë avokatët e angazhuar deri në fund të vitit të kaluar, për shkak të vështirësive financiare, jemi detyruar ta reduktojmë ekipin dhe tani avokat kryesor i z. Thaçi është z. Luka Misetić, i cili do të jetë në koordinim të plotë edhe me avokatët e tjerë ndihmës. Z. Kehoe ka qenë i informuar lidhur me

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 JANAR - Më 19 janar të këtij viti avokati kryesor Gregory Kehoe, në emër të ekipit mbrojtës të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ka njoftuar përmes një parashtrere se ish-eprori i UÇK-së “ka dështuar t’i përmbushë obligimet” sa iu përket pagesave, prandaj avokatët

kanë paralajmëruar se do të tërhiqen nëse këto obligime nuk përmbushen. “Mbrojtësi kryesor i z. Hashim Thaçi, Gregory Kehoe, bashkavokati Joe Reeder, së bashku me bashkëpunëtorët ligjorë dhe anëtarët e ekipit mbështetës të punësuar nga Greenberg Traurig, P.A. (‘Anëtarët e ekipit mbështetës të Greenberg’), paraqesin këtë mocion për t’u tërhequr në pajtim me nenin

16(2)(b) të Direktivës së Dhomave të Specializuara të Kosovës për avokatët”, është thënë në kërkesën e tyre drejtuar Dhomave të Specializuara, për të vazhduar tutje se: “Z. Thaçi nuk ka përmbushur detyrimin ndaj Gregory Kehoe, Joe Reeder, Associates Greenberg Legal dhe anëtarëve të ekipit mbështetës dhe z. Thaçit i është dhënë një paralajmërim i

'Çlirimtarët pa mbrojtje në Gjykatën Speciale, Kurti dhe qeveria heshtin'

PRISHTINË, 30 JANAR - Ish-presidenti Hashim Thaçi do të mbetet pa avokatin e tij kryesor Gregory Kehoe. Avokatët e ish-presidentit Thaçi të cilët po e mbrojnë në rastin e tij në Hagë, përmes një mocioni kanë paralajmëruar tërheqjen nga kjo detyrë për shkak të mospagesës.

E ky lajm ka ngjallur reagime në Kosovë.

Ish-zëvendëskryeministrja Edi Tahiri ka shkruar në "Facebook" se çlirimtarët kanë mbetur pa mbrojtje në Gjykatën Speciale, ndërkaq Kurti dhe qeveria heshtin. "Çlirimtarët pa mbrojtje në Gjykatën Speciale,

Kurti e Qeveria heshtin. Kur e kemi çliruar Kosovën, nuk kemi besuar se do të mund të kemi një kryeministër të tillë.. fatkeqësi institucionale...", ka shkruar Tahiri.

Ndërkaq gazetari Lirim Mehmetaj ka thënë se ky lajm është turp për shtetin dhe për gjithë shoqërinë. Ai ka kujtuar se Kroacia ka paguar 75 milionë euro vetëm për Ante Gotovinën. "Hashim Thaçit po i ikën avokati kryesor i tij, Gregory Kehoe, për shkak të pamundësisë për ta paguar. Sipas Ligjit, Ministria e Drejtësisë mundet në vit të paguajë veç një 1 milion e pak

dhe këto para i merr avokati Luka Mëshetiç. Nëse do avokat tjetër, apo kompani tjetër të avokatisë, atëherë duhet ta angazhosh privatisht. Privatist Thaçi s'po mund ta paguajë. E qysh? A nuk qenkan bërë këta miliarderë duke vjedhur pas luftës në Kosovë a? Qysh komandantët s'paskan pare a? Përndryshe ky është turp për shtetin dhe për gjithë shoqërinë. Kroacia për gjeneralin e vet, Ante Gotovina, i ka paguar 75 milionë zyrtarisht për mbrojtje dhe qindra miliona të tjerë jo zyrtarisht. Po na s'jemi ashtu, me gjasë s'jemi kurrfarë", ka shkruar Mehmetaj.

Adil Behramaj, ish-këshilltar i ish-presidentit Hashim Thaçi, ka reaguar ndaj Ministrisë së Drejtësisë, e cila ka bërë publike shpenzimet e avokatëve për ish-kryerët e UÇK-së në Hagë. Ai theksuar se me sa nguti dhe "transparencë" i publikon ministria e Albulena Haxhiut shpenzimet e avokatëve për ish-kryerët e UÇK-së në Hagë, të cilat do të duhej të ishin informacione të klasifikuara për shkak të rëndësisë shtetërore. "Që të mund t'i përdorin dhe përmendin kështu, këta edhe aktet nënligjore i kanë ndryshuar për t'i publikuar shpenzimet individuale dhe jo

shpenzimet në total, siç kanë qenë më herët. Po ashtu, me vendim të kryeministrit Kurti është ulur edhe niveli i klasifikimit.

Ndërsa, shpenzimet e Prindon Sadriut, bashkëshortit të presidentes Osmani, i mbajnë fshehur edhe pas vendimit të Agjencisë për Informim dhe Privatësi, e cila i gjobit dhe sërish nuk i bëjnë publike. Ata që janë në Hagë, familjet e tyre, familjet që sakrifkuan për këtë vend, do ta kalojnë edhe këtë sfidë. Por, shumë shpejt, disa do të mbesin përjetësisht të turpëruar!", ka shkruar Behramaj në "Facebook".



vështirësitë në mbulimin e kostos së shërbimeve të ekipit të tij dhe për mosvazhdimin e kontratës në vitin 2024. Ne e falënderojmë z. Kehoe dhe ekipin e tij për angazhimin e deritashëm dhe për punën e mirë që e kanë bërë në mbrojtjen e z. Thaçi. Po ashtu, besojmë se ekipi aktual do ta vazhdojë me përkushtim të plotë mbrojtjen dinjitoze ligjore dhe në fund të këtij procesi do të dëshmohej pastërtia dhe e vërteta e luftës së UÇK-së", ka thënë vëllai i ish-presidentit Thaçi, Idriz Thaçi.

Ministria e Drejtësisë (MD) ka dalë me një sqarim sa iu përket pagesave për ekipin mbrojtës të ish-eprorit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, që po gjykohet para

Dhomave të Specializuara të Kosovës, me seli në Hagë, pasi avokatët e Thaçit paralajmëruan tërheqjen nga rasti nëse nuk pranojnë pagesat.

MD-ja tha se në përputhje me legjislacionin në fuqi për pagesën apo kompensimin e ekipeve mbrojtëse të akuzuarve në Hagë, realizon pagesat vetëm me avokatët me të cilët ka marrëveshje. "Ministria e Drejtësisë përmes këtij njoftimi, dëshiron të mirëinformojë publikun e gjerë dhe të sqarojë lajmet lidhur me pagesat e avokatëve të personave të cilët akuzohen nga Dhomat e Specializuara të Kosovës. Në përputhje me Udhëzimin Administrativ numër 08/2022 për Mbrojtjen Juridike të Personave të Akuzuar

Potencial për Krimet e Pretenduara në Proceset Gjyqësore pranë Dhomave të Specializuara, Ministria e Drejtësisë ka lidhur marrëveshje për përfaqësim me avokatët përkatës të personave të akuzuar, në këtë rast, me mbrojtjen e z. Hashim Thaçi, për të cilin rast, raportohet tërheqja e mbrojtjes për shkak të mos realizimit të pagesave. Në përputhje me Udhëzimin dhe Marrëveshjen e tillë (legjislacionin në fuqi), Ministria e Drejtësisë ka kryer të gjitha obligimet lidhur me pagesën apo kompensimin e mbrojtjes së z. Hashim Thaçi. Për më shumë, vetëm për vitin 2023, Ministria e Drejtësisë ka realizuar pagesa për mbrojtësit e z. Hashim Thaçi në shumën

prej 1,371,800.00 euro", është bërë me dije në njoftimin e MD-së.

Sipas MD-së, pagesat për mbrojtjen e Hashim Thaçit janë realizuar për vitet 2020, 2021, 2022 dhe 2023. "Për vitin 2020, është realizuar pagesë prej 83,107.41 euro, për vitin 2021 është realizuar pagesë prej 1,114,901.00 euro, për vitin 2022 pagesa është realizuar në shumën prej 996,600.00 euro, dhe për vitin 2023 - është realizuar pagesë në shumën prej 1,371,800.00 euro. Për të gjitha vitet, shuma e pagesës për mbrojtjen e z. Hashim Thaçi, është 3,566,401.41 euro. Për sqarim tutje, Ministria e Drejtësisë realizon pagesa vetëm me avokatët me të cilët ka marrëveshje, në përputhje me

legjislacionin në fuqi. Aktualisht, Ministria e Drejtësisë ka marrëveshje me avokatin mbrojtës të Hashim Thaçit, Luka Mësiç, të cilit në përputhje me marrëveshjen, i realizon të gjitha pagesat me kohë", është thënë në njoftimin e kësaj ministrie, duke theksuar se për avokatët tjerë potencial, qoftë edhe privat, të cilët angazhohen nga Thaçi, Ministria e Drejtësisë nuk ka marrëveshje dhe nuk mbanë përgjegjësi për realizimin e pagesave. "Pra, Ministria e Drejtësisë, në përputhje me Udhëzimin e tillë dhe legjislacionin në fuqi, ka realizuar me kohë të gjitha pagesat dhe obligimet për mbrojtjen e z. Hashim Thaçi", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Asnjë njohje që tre vjet: Liberalizimi i vizave mund të ndihmojë



PRISHTINË, 30 JANAR - Pas pak jave Kosova pritet ta shënojë vitin e saj të 16 shtet, mirëpo në tri vitet e fundit shtetësia e saj nuk është njohur nga asnjë vend. Opsione për të dalë nga kjo status-quo, sipas njohësve të marrëdhënieve ndërkombëtare, ka.

Shfrytëzimi i liberalizimit të vizave për krijimin e raporteve diplomatike dhe ndihma e aleatëve për lobim janë dy nga to. Izraeli ka qenë vendi i fundit që e ka njohur pavarësinë e Kosovës, të shpallur më 17 shkurt të vitit 2008. Kjo njohje ka ndodhur në shkurt të vitit 2021 dhe ka qenë zotim i Marrëveshjes së Uashingtonit - e nënshkruar në mes të Kosovës dhe Serbisë më 4 shtator 2020 në praninë e presidentit të atëhershëm amerikan Donald Trump.

Para saj, shteti i fundit që e ka njohur Kosovën ka qenë Barbadosi në vitin 2018.

Në listën që e ka të publikuar Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë në uebfaqen e saj, figurojnë 117 vende që e njohin Kosovën.

Radio Evropa e Lirë dërgoi pyetje në këtë ministri rreth angazhimit të saj për njohje, por nuk mori përgjigje.

Shteti më i ri në Evropë vazhdon të mos njihet nga dy fqinjët e tij rajonalë, Serbia - e cila me Kushtetutë vazhdon ta konsiderojë si pjesë të veten - dhe Bosnjë-Hercegovina, si dhe nga pesë shtete anëtare të Bashkimit Evropian: Spanja, Sllovakia, Qiproja, Rumania dhe Greqia.

Kjo me gjithë faktin se Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka

konstatuar në vitin 2010 se pavarësia e Kosovës "nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar". REL-i, po ashtu, pyeti ministrinë e Jashtme të shteteve mosnjohëse të BE-së nëse janë duke shqyrtuar ndryshimin e qëndrimit dhe nën cilat kushte do ta bënin një gjë të tillë.

Ajo e Sllovakisë tha se "pozicioni i saj, në raport me pavarësinë e Kosovës, nuk ka ndryshuar", ndërsa e Rumanisë tha se fillimisht Kosova duhet t'i zgjidhë problemet me Serbinë. "Ne e mbështesim plotësisht dhe në mënyrë aktive dialogun e lehtësuar nga BE-ja si kanali kryesor për një normalizim efektiv dhe gjithëpërfshirës të marrëdhënieve Beograd - Prishtinë", tha MPJ-ja në Bukuresht.

Këtë muaj Spanja i njohu pasaportat e Kosovës, por autoritetet e këtij vendi sqaruan për REL-in se kjo nuk nënkupton njohje të Kosovës.

Nga Qiproja dhe Greqia nuk pati përgjigje.

Si mund të ndikojë liberalizimi i vizave në njohje?

Alejandro Esteso Perez, analist dhe studiues i politikave të Ballkanit dhe zgjerimit të BE-së, thotë për Radion Evropa e Lirë se me liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës "diçka mund të lëvizë".

"... sepse, mbajtësit e pasaportave të Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në shumicën e

këtyre vendeve [të BE-së] dhe kjo do të ketë ndikim në lidhjet ndërpersonale dhe lidhjet ndërmjet Kosovës dhe vendeve mosnjohëse të BE-së, veçanërisht në nivel social dhe kulturor", thotë Perez, i cili ligjëron në Universitetin Complutense të Madridit.

Sipas tij, liberalizimi i vizave është një pikënisje e mirë për ta bërë një hap më tej dhe "për t'i forcuar ose, në disa raste, për t'i vendosur lidhjet diplomatike dypalëshe".

Nga 1 janari i këtij viti qytetarët e Kosovës kanë fituar të drejtën e udhëtimit pa viza në atë që njihet si Zona Schengen dhe përbëhet prej 27 shtetesh evropiane.

Vetëm pak ditë më vonë, më 6 janar, Spanja ka njoftuar se do t'i njohë pasaportat e Kosovës.

Perez thotë se jo të gjitha vendet mosnjohëse e pengojnë integrimin evropian të Kosovës. Përkundrazi, shton ai, janë disa që e njohin, por nuk e mbështesin.

"Greqia ka një zyrë diplomatike në Prishtinë dhe gëzon një marrëdhënie të frytshme ekonomike dhe politike me Kosovën. Mirëpo, jo të gjithë njohësit janë mbështetës të Kosovës në çdo kohë. Shikojeni Hungarinë, aleanca e së cilës me Serbinë është duke ndikuar në qasjen skeptike ndaj procesit të integritimit evropian të Kosovës", thotë Perez, pa specifikuar më shumë.

Kryeministri populist i Hungarisë, Viktor Orban, është aleat i presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq. "Derisa Serbia të integrohet [në BE], Ballkani Perëndimor nuk do të integrohet", ka thënë Orban

gjatë një vizite në Beograd në korrik të vitit 2021.

"Së pari në Evropë, pastaj me njohjet"

Adnan Qerimagiq, analist në Iniciativën për Stabilitet Evropian, thotë për Radion Evropa e Lirë se Kosova duhet të fokusohet së pari në anëtarësimin në Këshillin e Evropës, në NATO dhe në Bashkimin Evropian, e pastaj, me ndihmën e aleatëve, t'i bindë vendet mosnjohëse. "Në këtë mënyrë, Kosova dhe partnerët e Kosovës në Këshillin e Evropës, në Bashkimin Evropian, por edhe në NATO do të kenë më shumë mundësi për ta shtyrë përpara njohjen e Kosovës", thotë Qerimagiq.

Sipas tij, "zbutja" e Spanjës karshi pasaportës së Kosovës ka dëshmuar se vendet mosnjohëse, mund t'i ndryshojnë politikat ndaj Kosovës. "Ajo çfarë na është dëshmuar në këto vitet e fundit, jo vetëm me luftën Ukrainë-Rusi, por edhe me atë se çfarë po bën Serbia në rajon dhe me narrativën dhe politikat karshi fqinjëve të saj, tregon se çështja nuk është vetëm te njohjet... por është edhe në interesin e vendeve evropiane që ta integrojnë Ballkanin Perëndimor në familjen euroatlantike për të siguruar stabilitet dhe paqe në rajon", thotë Qerimagiq.

Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës në maj të vitit 2022 dhe po atë vit, në dhjetor, ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Pasi Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, në shkurt të vitit 2022, në Kosovë kanë thënë se i kanë shtuar përpjekjet për anëtarësim edhe në NATO.

Vendi tashmë është anëtar i disa organizatave ndërkombëtare - në mesin e tyre: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Komiteti Olimpik, Federata Evropiane e Futbollit dhe Federata Botërore e Futbollit.

Me vite, Serbia ka qenë e angazhuar në një fushatë kundër njohjes së Kosovës apo për çnjohje të saj. Edhe pse autoritetet atje kanë thënë se kanë arritur t'i bindin disa vende për t'i tërhequr njohjet e Kosovës - në mesin e tyre: Surinami, Burundi, Liberia, Ishujt Solomon etj. - autoritetet e Kosovës nuk kanë konfirmuar ndonjë çnjohje. Diplomacia e Kosovës është kritikuar në disa raste për mungesë strategjie.

Por, në një intervistë dhënë mediumit Kallxo në Kosovë, në muajin dhjetor, shefja e diplomacisë kosovare, Donika Gërvalla, ka thënë se po punohet për njohje të reja. "Unë s'mund t'ua imponoj vullnetin tim shteteve të tjera. Ajo çfarë mund të bëj, është që të mos e ndal punën asnjë ditë", ka thënë Gërvalla.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, përsërit vazhdimisht se njohja e Kosovës nga Serbia, nuk do të ketë alternativë.

Dy vendet janë në negociata për normalizimin e marrëdhënieve për më shumë se një dekadë, por marrëveshjet e arritura mes tyre kanë gjetur pak zbatim.

Ministrja Haxhiu mbledhi Bordin Këshillëdhënës të Institucionit të Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik

PRISHTINË, 30 JANAR - Me qëllim të ngritjes së përgjegjësisë dhe funksionalizimit efektiv të këtij Bordi, ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka mbledhur anëtarët të cilët përfaqësojnë institucione të larta të vendit si Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Koordinatorin Nacional për Luftimin e Krimit Ekonomik, Drejtorinë e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit etj.

Ministria e Drejtësisë ka njoftuar se ky Bord që prej themelimit të tij në vitin 2014 është mbledhur vetëm tri herë deri më tani, gjë që tregon edhe për neglizhencë kundrejt rëndësisë që do të duhej të kishte ky organ në luftimin e krimit ekonomik në Kosovë. "Si fillim të gjithë anëtarët e Bordit u dakorduan për mbledhje të shpeshta dhe të rregullta, për bashkëpunimi ndërinstytucional të intensifikuar. Në këtë

takim u ritheksuan zëshëm kompetencat dhe përgjegjësitë që Koordinatorin Kombëtarë për Luftimin e Krimit Ekonomik ka, veçmas për raportim përpara këtij Bordi. Nga kjo mbledhje u konstatua se duhet sa më parë të bëhet interpretimi i dispozitave për sekuestrimin dhe konfiskimin, qartësim dhe përmirësim të politikave ndëshkimore, si dhe u theksua nevoja për të mbajtur trajnime me zyrtarët përkatës



në profilin përkatës (krim fajde etj)", ka njoftuar ekonomik, pastrim parash, Ministria e Drejtësisë.

Policia thotë se thasët me rërë që u gjetën në Zveçan ishin përdorur në barrikada

PRISHTINË, 30 JANAR - Policia e Kosovës ka bërë me dije se në një objekt publik në Zveçan ka gjetur disa materiale "të cilat janë shfrytëzuar nga grupet terroriste serbe në kohën e barrikadave". Zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, tha për Radion Evropë e Lirë se aksioni në Zveçan u realizua në bashkëpunim me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX). "Sot gjatë kontrolleve që ka bërë Policia ka konstatuar se në katin e tretë të kësaj ndërtese janë dhjetëra thasë të mbushura me rërë, që kanë qenë si istikame për ta sulmuar Policinë dhe në mbrojtje të barrikadës dhe

kontrollimin e rrugës kryesore që të dërgon në Zveçan", tha ai. Elshani tha se autoritetet kanë marrë informacione se potencialisht ka "diçka të paligjshme" në objektin që gjendet në hyrjen e Zveçanit nga drejtimi i Mitrovicës së Veriut. Sipas Elshanit, objekti ku u gjetën thasët me rërë është shfrytëzuar nga pjesëtarët e "Mbrojtjes Civile" dhe "Brigadës së Veriut". "Mbrojtja Civile" dhe "Brigada e Veriut" janë shpallur organizata terroriste nga Qeveria e Kosovës dhe autoritetet kanë thënë se ato veprojnë në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe. "Kjo është një dëshmi se grupet kriminale kanë qenë të armatosura rëndë dhe kanë



pasur plane që ta sulmojnë Policinë e Kosovës në rast se ata do të tentonin t'i largonin

barrikatat", tha Elshani. Zveçani është një ndër katër komunat në veri të Kosovës të

banuara me shumicë serbe. Në të kaluarën, serbët lokalë kanë ngritur barrikada në rrugë, duke përdorur mjete të ndryshme të rënda, sikurse kamionët, për t'i bllokuar rrugët në shenjë pakënaqësie me vendime të ndryshme të Qeverisë së Kosovës. Barrikatat e fundit që u ngritën në veriun e Kosovës - përfshirë në Zveçan - në dhjetor të vitit 2022, pas arrestimit të një ish-policit të Kosovës nga komuniteti serb, nën dyshimet se kishte sulmuar zyrtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri. Barrikatat u hoqën vetëm pasi ish-policit Dejan Pantiq iu ndryshua masa e sigurisë nga paraburgim në arrest shtëpiak.

Jasharaj kërkon debat për arsimin në Kosovë

PRISHTINË, 30 JANAR - Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, dhe nënkryetarja Vjollca Shala janë takuar në ambientet e Kuvendit të Kosovës me kryetarin e Komisionit Parlamentar për Arsim, Ardian Gola. Jasharaj ka deklaruar se janë shumë çështje në arsim që duhen debatuar, prandaj ka kërkuar nga kryetari Gola të organizohet një takim i anëtarëve të Komisionit parlamentar për Arsim me përfaqësuesit e SBASHK-ut për të debatuar për të gjitha çështjet aktuale në arsim dhe për të bërë bashkërisht përpjekje në shërbim



të ngritjes së cilësisë në arsim. Jasharaj i ka shprehur shqetësimet e SBASHK-ut edhe

lidhur me ndryshimet që janë bërë në skemën pensionale e që kanë prekur në të drejtat e fituara

të punëtorëve të pensionuar arsimorë dhe ka lutur Golën të gjejë kohë për t'u takuar me përfaqësuesit e SBASHK-ut, që do të ofronin fakte dhe argumente për çështjen e ngritur. Kryetari i Komisionit Parlamentar për Arsim, deputeti Ardian Gola, ka shprehur gatishmërinë për të realizuar së shpejti takim me përfaqësuesit e SBASHK-ut lidhur me çështjen e ngritur për skemat pensionale dhe për një takim me Komisionin Parlamentar për Arsim. Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, e ka informuar kryetarin Gola për gjithë

angazhimet që janë bërë e do të bëhen në mënyrë që Konferenca e 20 dhe 21 shkurtit "Kujdesi për shëndetin mendor në shkollat e Kosovës" të jetë e organizuar mirë dhe t'i arrijë objektivat e parapara. Gola ka përgëzuar SBASHK-un dhe Qendrën Amerikane të Solidaritetit për idenë e qëlluar të mbajtjes së këtij aktiviteti duke uruar që panelistët dhe pjesëmarrësit të japin kontribut të lartë me qëllim që të nxirren edhe rekomandime për të gjithë palët se çfarë mund të bëhet në të ardhmen në shërbim të arsimit në Kosovë.

Kurti vizitoi Inspektoratin Policor të Kosovës

PRISHTINË, 30 JANAR - Gjatë ditës së djeshme kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, kanë vizituar Inspektoratin Policor të Kosovës. Ata janë pritur nga kryeshefi ekzekutiv Kushtrim Hodaj. Në takim janë paraqitur angazhimet dhe arritjet e IPK-së gjatë vitit 2023 si dhe

prioritetet e vitit 2024. Profesionalizmi dhe angazhimi i Inspektoratit Policor të Kosovës reflekton në efikasitetin dhe ngritjen e kapaciteteve të Policisë së Kosovës. Në mesin e temave të diskutuara ishin edhe rëndësia e trajtimit efikas të rasteve të raportuara nga qytetarët, ruajtja e të dhënave të raportuesve si

dhe trajtimi i paanshëm dhe profesional i rasteve të pranuar. Duke shprehur mirënjohje për punën dhe angazhimin e tyre, kryeministri e falënderoi Inspektoratin dhe përfaqësuesit për bisedën dhe përkushtimin e vazhdueshëm dhe ofroi mbështetjen e mëtutjeshme për realizimin e detyrave të tyre.



Importet e Kosovës nga shtetet CEFTA-s në dhjetor arritën një vlerë prej 69,1 milionë eurove

PRISHTINË, 30 JANAR - Gjatë muajit dhjetor të vitit 2023 tregtia në mes të Kosovës dhe vendeve të CEFTA-s (Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore) u shënuar me një rënie të qarkullimit të mallrave, megjithatë shkëmbimi ka ruajtur ende një masë të konsiderueshme me vlera që kapin dhjetëra miliona euro. Ndërsa shkëmbimi tregtar ka pësuar një ulje, Shqipëria vazhdon të qëndrojë si partnerja tregtare numër një e Kosovës për muajin e fundit të vitit.

Importet e Kosovës nga shtetet CEFTA në dhjetor arritën një vlerë prej 69,1 milionë eurosh, duke zënë 12,7 për qind të totalit të importeve. Kjo shumë përbën një ulje prej 25,5-përqindësh krahasuar me periudhën e njëjtë në vitin e kaluar. Në të dhënat e importit, Shqipëria zë vendin e parë me një pjesë prej 5,4-përqindësh, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 4,4 për qind dhe Serbia me 1,8 për qind.

Një turrje prej 5,9-përqindësh u vërejt edhe në eksportet e Kosovës drejt vendeve CEFTA, ku shumica e të ardhurave nga shitja e mallrave



arriti në 28 milionë euro, ose 42,7 për qind e të gjitha eksporteve. Shqipëria mbetet edhe në eksport lideri kryesor, duke marrë pjesë

me 18,3 për qind, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 12,5 për qind, Serbia me 5,8 për qind dhe Mali i Zi me 4,9 për qind.

Sa i përket vëllimit total të tregtisë së jashtme të Kosovës për muajin dhjetor, importet shënuan një ngritje në 543.1 milionë euro, që


paraqet një rritje prej 4,1-përqindësh.

Eksportet, nga ana tjetër, panë një rënie prej 9,3-përqindësh, me një vlerë totale prej 65,4 milionë eurosh, në krahasim me tregtinë e vitit të mëparshëm në të njëjtin muaj.

Nga të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) bëhet e qartë se deficitit tregtar i Kosovës ka shënuar një rritje prej 6,3-përqindësh në dhjetorin e vitit 2023 në krahasim me të njëjtin muaj të vitit të kaluar, duke arritur në vlerën prej 477,7 milionë eurosh, nga 449,5 milionë euro që ishte një vit më parë. Ky rritje e deficitit tregon një kthjelltësi më të madhe të importeve në raport me eksportet e vendit.

Megjithatë, eksportet për muajin dhjetor arritën të mbulojnë 12 për qind të importeve, ku Kosova ka treguar një profil eksportues të diversifikuar. Sipas ASK-së, mallrat që u eksportuan më së shumti përfshijnë metale bazë dhe artikuj të përpunuar prej tyre, duke zënë 21 për qind të eksporteve totale.

ATK-ja ndryshon procedurat për pajisje me vërtetim tatimor



PRISHTINË, 30 JANAR - Administrata Tatimore e Kosovës ka bërë me dije se, bazuar në Ligjin nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, i cili ka hyrë në fuqi nga data 28 janar 2024, ka nxjerrë udhëzuesin me të cilin plotëson/ndryshon procedurat për pajisje me vërtetim tatimor.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është informimi i personave/tatimpaguesve për procedurat që duhen ndjekur për t'u pajisur me vërtetim tatimor, përgjegjësitë e zyrtarëve të Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale për ta lëshuar vërtetimin tatimor, si dhe përgjegjësitë e zyrtarëve të Teknologjisë Informative në ATK për ta mundësuar gjenerimin e vërtetimit tatimor. "Pajisja me vërtetim tatimor mund të bëhet në mënyrë elektronike dhe në mënyrë manuale. Tatimpaguesi (biznesi) mund të pajiset me vërtetim tatimor online përmes Sistemit Elektronik EDI apo në zyrën përkatëse rajonale të Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve. Ndërsa personi fizik jo-afarist (individ) mund të

pajiset me vërtetim tatimor online përmes uebfaqes së ATK-së apo në cilëndo zyre rajonale më të afërt të Shërbimit dhe Edukimit të Tatimpaguesve", ka njoftuar ATK-ja.

Vërtetimi tatimor për personin fizik afarist dhe personin juridik lëshohet nga ATK-ja vetëm në rastet kur tatimpaguesi nuk ka ndonjë detyrim tatimor të pashlyer dhe në rastet kur tatimpaguesi ka obligime të pashlyera, mirëpo është në marrëveshje për pagesë të atij borxhi me këste.

Ndërsa vërtetimi tatimor për personin fizik jo afarist (individin) lëshohet nga ATK-ja vetëm në rastet kur personi nuk ka ndonjë detyrim tatimor të pashlyer, në rastet kur personi ka obligime të pashlyera, mirëpo është në marrëveshje për pagesë të atij borxhi me këste dhe në rastet kur ATK-ja nuk ka shënime për personin.

Ky udhëzues hyn në fuqi në datën e nënshkrimit, ndërsa fillon të zbatohet nga data 1 shkurt 2024 dhe i njëjti shfuqizon "Udhëzuesin lidhur me procedurat e pajisjes me Vërtetim Tatimor" të datës 18 shtator 2023.

Ambasadori gjerman takohet me kryeshefin e KOSST-it: Integrimi i komunave veriore, hap i rëndësishëm

PRISHTINË, 30 JANAR - Ambasadori i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, është takuar me kryeshefin ekzekutiv të KOSST-it, Evatar Zeqiri, për të folur mbi bashkëpunimin në mes të Kosovës dhe Gjermanisë

në sektorin e energjisë. Në një njoftim të ambasadës gjermane u tha se integrimi i katër komunave me shumicë serbe është hap i rëndësishëm për operatorin. "Gjatë një takimi mjaft informues me

kryeshefin e KOSST-it, Evatar Zeqiri, ambasadori Rohde theksoi bashkëpunimin e madh me Gjermaninë dhe mbështetjen e kahershme të KfW Bankengruppe në sektorin e energjisë. Integrimi i

mëtejshëm i katër komunave veriore ka qenë një hap i rëndësishëm për biznesin e qëndrueshëm të operatorit", theksohet në njoftimin e Ambasadës së Gjermanisë në Prishtinë.



Michelle Obama në Shtëpinë e Bardhë? Rikthehen zërat

Në prag të zgjedhjeve paraprake në New Hampshire, rikthehet “fantazma” e Michelle Obamas, e dhënë si kandidate për zbritjen në garën brenda Partisë Demokratike, duke u përpjekur të hipotekojë nominimin përballë ciklonit Trump, i cili po shkakton “viktima” mes shokëve të garës. Javët e fundit kishte pasur thashetheme për kandidaturën e mundshme të Michelle – një hipotezë e cila ka qarkulluar që kur burri i saj u largua nga Shtëpia e Bardhë.

Thashethemet e New York Post për Michelle Obama

Asgjë që nuk është thënë dhe dëgjuar tashmë e që ka qarkulluar në fillin e thashethemeve që nga viti 2020, mes shpresave të ngjallura nga elektorati demokrat – të etur për të rjetuar “sezonin 2008” dhe konkluzioneve të thjeshta që duan Barakun flokëbardhë të orkestrojë lëvizjet e pallatit. Sipas tabloidëve, ish-Zonja e Parë e SHBA-së tashmë mund të jetë duke punuar për të kandiduar për Shtëpinë e Bardhë. Kështu ka shkruar New York Post, e cila pretendon se ka “burime të besueshme, në të cilat pak kanë akses dhe nga ata që zakonisht nuk flasin me gazetarët”. Sipas raportimeve, “Obama ka bërë një testim mes donatorëve” dhe strategjia tashmë është vendosur: Biden do të shpallë që nuk do të kandidojë në maj dhe gruaja e Barack Obamës do të kurorëzohet në konventën e Demokratëve në gusht.

Megjithatë, deri atëherë, Biden do të sillet “sikur të ishte kandidati i vërtetë”: një që pakkush po e merr seriozisht. Gazeta kishte zbuluar se mbi një vit më parë, në verën e vitit 2022, në një takim me CEO të rëndësishëm, ajo vetë kishte deklaruar: “Kam ndërmend të kandidoj dhe kërkoj mbështetjen tuaj”. Por një sfidë e drejtpërdrejtë ndaj Bidenit ishte e paimagjinueshme, kështu që – përsëri sipas rindërtimit të Post-it – presioni për të bindur Bidenin do të fillojë sapo të mbarojë cikli i primareve, dhe pak para kurorëzimit të konventës.

Sa e vërtetë është fushata e pretenduar e zonjës Obama

Gjatë peshimit të lajmit, duhet të merren parasysh dy aspekte themelore. E para: New York Post është një tabloid, konservator. Nuk është për t’u habitur që ai mund të dëshirojë të përziejë kartat dhe të krijojë një stuhi në fushatën elektorale të kundërshtarit. E dyta: data e majit do të dukej disi e pamundur, nëse lajmi do të ishte i vërtetë. Duke marrë parasysh trajektoren rënëse të ndërmarrë nga Biden, korrigjuesi duhet të përdoret menjëherë, për të lejuar



kandidaten Michelle të konkurrojë me konsensus elektorale. Ajo që deri më sot e ka matur veten ekskluzivisht me konsensusin popullor. Por një gjë është duartrokitja dhe tjetër votat dhe donacionet.

Sipas rikonstruksionit të gazetës, bashkëshorti i famshëm do të shqetësohej gjithnjë e më shumë për mundësinë që ish-zëvendëspresidenti i tij të mos e mundte sërish Trumpin në një përplasje të drejtpërdrejtë. “Obama ka testuar ujërat me

donatorët e tij”, shkruan Post, duke cituar burime të informuara, sipas të cilave edhe dalja publike disa javë më parë e ish-gruas së parë të Amerikës, e cila në një intervistë tha se mundësia e rikthimit të Trumpit “tmerron” dhe e lë pa gjumë, nuk ka qenë e rastësishme por është gjithmonë pjesë e orkestrimit të kujdesshëm të të shoqit. Sipas tabloidit, ish-presidenti po i bën presion fshehurazi 80-vjeçarit Biden dhe stafit të tij për ta bindur atë të japë dorëheqjen.

Obama, tashmë strateg i fushatës së Bidenit

Manovra që nuk janë edhe aq të fshehta nëse merret parasysh qëndrimi i mbajtur nga David Axelrod, ish-strategu i Obamës, i cili publikisht vuri në dyshim faktin se zgjedhja e Bidenit, për të kandiduar për t’u rizgjedhur ishte “e mençur” ose “në interes të vendit”. Për më tepër, roli i Obamës si “strateg” në fushatën elektorale demokrate është

i hapur, siç ishte në fushatën zgjedhore afatmesme. Në fillim të këtij muaji, në fakt, ishte Washington Post që përhap lajmin për një takim në të cilin, sipas burimeve të cituara nga Post në kushte anonimiteti, Biden pranoi sugjerimin për të afruar ish-bashkëpunëtorët e Obamës. Për më tepër, ky i fundit do të kishte diktuar edhe linjën “editoriale” të fushatës elektorale: bashkëpunëtorëve të presidentit amerikan do t’u ishte kërkuar të mbanin një nivel komunikimi dukshëm agresiv.

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Drita përforcohet me kolumbianin Mesa

GJILAN, 30 JANAR - Skuadra e Dritës ka vazhduar me përforcime, derisa Juan Camilo Mesa është lojtari më i ri i gjilanasve. Qendërmbrojtësi kolumbian i bashkohet Dritës nga kampionati shqiptar, ku së fundmi ishte pjesë e Dinamo Cityt. 25-vjeçari ka nënshkruar kontratë me

Dritën për një vit e gjysmë. “Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë që kemi arritur marrëveshje për transferimin e kolumbianit Juan Camilo Mesa. Mesa luan në pozitë e qendërmbrojtësit dhe së fundmi ishte pjesë e Dinamo City nga kampionati

shqiptar. Lojtari është pritur nga drejtori sportiv, Valon Zymberi, i cili i dëshiroi mirëseardhje në klubin tonë. Mesa ka nënshkruar marrëveshje me klubin për një vjet e gjysmë dhe do të jetë me ne deri në qershor të 2025. Mirë se vjen Juan!”, thuhet në njoftimin e Dritës.



Kosova organizon dy Kampionate Evropiane, Saraçini: Arritje e madhe për FHK-në

EPOKA E Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 JANAR - Dy drejtuesit e Federatës së Hendbollit të Kosovës, presidenti Eugen Saraçini dhe sekretari i përgjithshëm, Izet Gjinoçvi janë kthyer nga Kolni i Gjermanisë me lajme pozitive. Drejtuesit e FHK-së në Gjermani janë njoftuar se federata kosovare do të jetë organizatore e dy Kampionateve Evropiane për hendbollistë: U20 dhe U18 që do të mbahen gjatë verës. Ndërsa vendimi është marrë nga Komiteti Ekzekutiv i Federatës Evropiane të Hendbollit me datën 29 janar. “Dëshirojmë të informojmë se FHK-ja, përkatësisht Kosova, do të jetë nikoqire e dy kampionateve evropiane. Atij U20 që do të mbahet nga data 13 deri më 21 korrik dhe U18 që do të mbahet

nga data 12 deri më 18 gusht. Këtë vendim e ka marrë Komiteti Ekzekutiv i Federatës Evropiane të Hendbollit me datën 29 të këtij muaji. Paraprakisht kemi qenë në komunikime të vazhdueshme dhe kemi shprehur gatishmërinë që të jemi organizator të këtyre ngjarjeve dhe pas diskutimeve të shumta kemi dëshmuar se jemi në gjendje të bëjmë një organizim të tillë. Federata Evropiane ka vendosur që këto dy ngjarje të mëdha të mbahen në Kosovë”, ka thënë presidenti Saraçini. “Kjo edhe ndoshta do të jetë arritja më e madhe e FHK-së në aspektin organizativ, ku në këto kampionate evropiane për meshkuj do të marrin pjesë edhe ekipet tona që do të sfidohen nga ekipet evropiane”, ka shtuar Saraçini, i cili më pas bëri me dije se ekipet kombëtare që do të



marrin pjesë në Kampionatin Evropian U20 do të jenë: Belgjika, Bullgaria, Estonia, Finlanda, Britani e Madhe, Gjeorgjia, Letonia, Luksemburgu, Lituania, Sllovakia, Turqia dhe Kosova. Ndërkohë, në Kampionatin Evropian U18 janë Azerbajxhani, Belgjika, Bullgaria, Britania e Madhe, Gjeorgjia, Luksemburgu

dhe Kosova. Pra, në kampionatin U20 do të paraqiten 12 ekipe, ndërsa në U18 do të jenë tetë ekipe kombëtare. I pari i FHK-së ka ftuar për bashkëpunim të gjithë partnerët e rëndësishëm të FHK-së, duke filluar nga MKRS-ja dhe sponsorët që të jenë partnerë në organizimin e këtyre eventeve të rëndësishme. “Në kuadër të

aktiviteteve të këtij viti do të kemi edhe ekipin U18 të femrave që nga data 28 shkurt do të marrë pjesë në turneun ‘EHF Trophy Intercontinental’ që Uzbekistan, e ku synojmë kualifikimin për Botërorin që mbahet në muajin gusht të këtij viti në Shanghai të Kinës. Ekipi U16 do të jetë pjesë e garave Mesdhetare që do të mbahet nga data 25 shkurt deri më 3 mars në Podgoricë. Ekipi A i femrave në fillim të muajit prill do të zhvilloj ndeshjet kualifikuese në kuadër të fazës finale për kualifikim në Evropianin 2024, ku do të përballet me Poloninë”, ka deklaruar Saraçini. Drejtuesit e FHK-së në fund kanë paralajmëruar se aktivitete të ndryshme do të kemi edhe në të ardhmen pasi bashkëpunimi është i mirë me federatën evropiane dhe ndërkombëtare të hendbollit.

Tshimanga i Trepçës, MVP i javës

MITROVICË, 30 JANAR - Në javën e 19-të, dy sfida janë vendosur në çastet e fundit. Trepça arriti fitoren e 12-të radhazi në elitë, duke mundur Proton Cable Prizrenin 68:71, derisa te mitrovicasit u dallua sërish Jordy Tshimanga me dyshifror të dyfishtë 18 pikë e 14 kërcime. Ai shtoi edhe dy topa të vjedhur dhe një bllokadë. Sigal Prishtina po ashtu shënoi fitore dramatike kundër Bashkimit, ku te bardhekaltrit, basketbollisti më i dalluar në parket ishte Derrick Wilson me dyshifror të dyfishtë, 18 pikë e 12 kërcime, si dhe dy



asistime. Në anën tjetër te prizrenasit më i miri ishte Will

Daniels me 24 pikë e dhjetë kërcime, si dhe dy asistime. Peja

shënoi fitore të pritur ndaj Istogut, që ka vetëm një fitore në këtë edicion, ndërsa te kampionët e Kosovës më i miri ishte Larry Thomas me 19 pikë, shtatë kërcime e gjashtë asistime. Fitore shumë të rëndësishme arriti Golden Eagle Ylli, që mundi Vëllaznimin në Gjakovë, ku më i miri te therandasit ishte Jalen Nesbitt me 17 pikë, pesë kërcime e dy asistime.

MVP

Jordy Tshimanga (Trepça) 18 pikë,

14 kërcime, / asistime, 30 indeksi

Top pesëshja

Jordy Tshimanga (Trepça) 18 pikë, 14 kërcime, / asistime, 30 indeksi
 Derrick Wilson (Sigal Prishtina) 18 pikë, 12 kërcime, 2 asistime, 27 indeksi
 Will Daniels (Bashkimi) 24 pikë, 10 kërcime, 2 asistime, 31 indeksi
 Larry Thomas (Peja) 19 pikë, 7 kërcime, 6 asistime, 24 indeksi
 Jalen Nesbitt (Golden Eagle Ylli) 17 pikë, 5 kërcime, 2 asistime, 21 indeksi

Dënohen gjyqtarët e ndeshjes Prishtina - Bashkimi

PRISHTINË, 30 JANAR - Treshja e gjyqtarëve në ndeshjen mes Prishtinës e Bashkimit, e zhvilluar në kuadër të xhiros së 19-të të Superligës së Kosovës, janë dënuar me dy ndeshje mosdelegim. Përballja mes dy rivalëve të vjetër, Prishtinës e Bashkimit, u diskutua ditëve të fundit për shkak të ndarjes së drejtësisë nga gjyqtarët kosovarë. Ndeshja përfundoi në të mirë të

Prishtinës, që arriti fitoren me vetëm një pikë dallim, me rezultat 84:83, ndërkaq kritika të ashpra kishte drejt treshes së gjyqtarëve. Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës ka marrë vendim që t'i dënojë gjyqtarët: Ngadhym Shabani, Eldin Uglari dhe Besim Vitaku. Pa u ndëshkuar nuk ka shpëtuar as delegati i ndeshjes, Albert Vërbiqi. Që të katër janë dënuar me nga dy

ndeshje mosdelegim. Përpos gjyqtarëve, nga kjo ndeshje dënime kanë pësuar edhe zyrtarë e basketbollistë nga të dyja klubet. Te Prishtina është dënuar Sirko e Wilson, ndërkaq te Bashkimi e ka pësuar Altin Morina. Lidhur me vendimet e gjyqtarëve, klubi i Bashkimit ka paraqitur ankesë në FBK, ndërsa ka publikuar momentet diskutabile edhe në faqen zyrtare të klubit.




Laporta synon rikthimin e Guardiols në Barcelonë

BARCELONË, 30 JANAR - Xavi Hernandez e ka zyrtarizuar vendimin për largim nga Barcelona në fund të këtij edicioni. Drejtuesit e klubit janë duke e kërkuar zëvendësuesin e Xavit. Së fundmi u përmend si opsion trajneri i tashëm i

Liverpoolit, Jurgen Klopp, i cili e ka konfirmuar largimin nga "Anfield Road" në fund të këtij sezoni. Ndërkohë, emisioni sportiv spanjoll "El Chiringuito" e ka hedhur "bombën" të martën. Sipas gazetarëve të këtij emisioni, presidenti i Barçës, Joan Laporta

po e ëndërron rikthimin e Pep Guardiols në Barcelonë për ta zëvendësuar Xavin. Guardiola e ka ndërmend ta vazhdojë epokën e suksesshme me Manchester Cityn, por futbollit nuk i dihet kurrë dhe deri në verën që vjen mund të ndodhë gjithçka.

Guardiola e ka në zemër Barcelonën, ku kishte eksperiencën të suksesshme dhe të paharrueshme si futbollist dhe si trajner. Andaj, nuk përjashtohet mundësia që një ditë ai të rikthehet në këtë klub, përsëri si trajner.



Hamilton: Mund të qëndroj një vit pushim dhe të rikthehem sërish në Formula 1

LONDËR, 30 JANAR - Tashmë 39-vjeçar, piloti britanik Lewis Hamilton ka edhe dy vite kontratë me Mercedesin. Çka do të thotë se 7 herë kampioni i botës në Formula 1 do të jetë në pistë deri në moshën 41-vjeçare. Po më tej? Vitin 2026 do të hyjë në fuqi motorët e ri dhe kjo risi mban disi pezull të ardhmen e britanikut. "Nuk kam thënë kurrë se titulli i tetë do të ishte pika e mbërritjes për mua", ka thënë Hamilton. "Nuk e ndjej domosdoshmërisht dëshirën për të qëndruar aktiv në Formula 1 për më gjatë, por kurrë mos thuaj kurrë. Nuk mund ta imagjinoj që të mos garoj më dhe të jem ende në një garazh diku. Në fakt, ndoshta do të mendoja se mund të shtoja një sezon tjetër dhe të konkurroja përsëri. Ndoshta do të ishte më mirë të bëja një pushim dhe të shikoja nëse dua të kthehem akoma", ishte komenti i Hamiltonit për të ardhmen e tij. Ndoshta britaniku dëshiron të veprojë si Fernando Alonso, që u rikthye pasi u tërhoq



nga garat. Piloti "i madh" i fundit që u tërhoq nga skena ishte Sebastian Vettel në fund të vitit 2022. Edhe gjermani, nuk përjashtoi një rikthim. "Rikthimi ndodhi me Fernando Alonso, Michael Schumacher dhe të

tjerë, madje edhe nga sporte të ndryshme. Unë fola me dikë për këtë, më tha se diçka që kishte bërë gjithë jetën tënde humbi papritur. Prandaj është normale të mungosh", ka deklaruar Hamilton.

Denveri fiton sfidën me Milwaukee, triumfojnë edhe Boston, Phoenix e Minnesota



DENVER, 30 JANAR - Ekipi kampion i Denverit fitoi me rezultat 113-107 ndaj Milwaukee, një përballje mes dy skuadrash pretendente për titull në NBA. Sfidë e ekuilibruar deri në fund, ku për Denverin u dalluan Murray me 35 pikë dhe Nikola Jokiq me një "triple double" (25 pikë, 16 rebound, 12 asistime). Për Bucks, Antetokounmpo

realizoi 29 pikë e 12 rebound, por që s'mjaftuan. Minnesota rimerr kreun e renditjes në Perëndim pas fitores me rezultat 107-101 në fushën e Oklahomës, që zbrit në vendin e tretë. Edwards me 27 pikë ishte shënuesi më i mirë për miqtë. Fiton edhe Bostoni, që mbron vendin e parë në Lindje. Celtics mposhtën me rezultat 118-

112 New Orleans, ndeshje ku u dalluan Tatum me 28 pikë e 10 rebound. Phoenixi, falë 23 pikëve të Gordonit e 22 të Bookerit, mundi me rezultat 118-105 Miami. Fiton edhe Clevelandi, që mundi me rezultat 118-108 Clippersat, ku protagonist ishte Mitchell me 28 pikë. Fitore në sekondat e fundit korri Dallasi, që mundi me rezultat 131-129 Orlandon, ndeshje ku Donqiq realizoi 45 pikë e Hardaway 36.

REZULTATET

Charlotte - New York	92-113
Cleveland - Clippers	118-108
Boston - New Orleans	118-112
Brooklyn - Utah Jazz	147-114
Miami - Phoenix	105-118
Houston - Lakers	135-119
Memphis - Sacramento	94-103
Oklahoma - Minnesota	101-107
San Antonio - Washington	113-108
Dallas - Orlando	131-129
Denver - Milwaukee	113-107
Portland - Philadelphia	130-104

Leverkuseni synon transferimin e Asensios

Bayer Leverkusen ka shprehur interesim për futbollistin e PSG-së, Marco Asensio. Lajmi është bërë i

ditur nga "Sky Germany". Ky do të ishte një transferim shumë i madh për ekipin gjerman, teksa ditë më para

ata afruan në radhët e tyre sulmuesin spanjoll, Borja Iglesias, në formën e huazimit deri në fund të sezonit. Që nga

transferimi i tij me parametra zero nga Reali te PSG-ja verën e kaluar, Asensio ka shënuar tre gola dhe ka asistuar një

herë në shtatë ndeshje të Ligue 1, por megjithatë, spanjolli ka humbur 12 ndeshje prej dëmtimit.

SHKURT

KB Prishtina e fiton Kupën e Veteranëve

Mitrovicë, 30 janar - Në fundjavë është zhvilluar Final 4 në Kupën e Veteranëve. Në Mitrovicë janë zhvilluar ndeshjet gjysmëfinale dhe finalja. Në ndeshjen e parë, Prishtina ka mundur Trepçën me shifrat 81:50, derisa në sfidën e dytë, Vëllaznimi ka mundur Pejën 50:58. Në finale Prishtina ka shënuar fitore kundër Vëllaznimit me rezultat 60:45. Kupën e Kosovës për Veteranë për edicionin 2023-2024 e fitoi KBV Prishtina. Lojtari MVP i turneut u shpall Edmond Azemi, i cili edhe ishte koshashënuesi më i mirë i turneut. Kupën kapitenit Arsrim Svirca dhe medaljet skuadrave finaliste i ndau Naim Hajrizi, kryetar i Komisionit për Veteranë.

Chelsea refuzon ofertën e Wolvesit për Brojën

Chelsea thuhet se ka refuzuar një oferta nga Wolves për huazimin e sulmuesit shqiptar, Armando Broja. Emri i bomberit kuqezi është njëri nga më të lakuarit në këtë merkato të janarit dhe pritet që ai të largohet nga "Stamford Bridge". Megjithatë, drejtuesit e "bluve" e vlerësojnë shumë Brojën, pasi janë të gatshëm vetëm të shesin kartonin e tij për një çmim prej 60 milionë eurosh. Gazetari i njohur italian dhe eksperti i merkatos, Fabrizio Romano, bën me dije se Wolves kishte paraqitur një ofertë huazimi për Armando Brojën, por Chelsea e kishte refuzuar menjëherë.

Milani shpreh interesim për Kumbullën

AC Milan është në kërkim të një mbrojtësi në orët e fundit të merkatos, teksa pista "Demiral" bëhet mjaft e vështirë për shkak se Al-Ahli nuk e lë të lirë. Për këtë arsye, kuqezinjtë kanë në plane që të transferojnë mbrojtësin e Kombëtares shqiptare, Marash Kumbulla. Edhe me ardhjen e trajnerit Daniele De Rossit, 23-vjeçari sërish nuk është në planet e Romës, me këtë të fundit që kërkon ta largojë menjëherë në mënyrë që të ketë vend për Anxhelinjon. Milani është i gatshëm të ulet në tavolinën e bisedimeve me Romën për Kumbullën, i cili shihet si opsion i vlefshëm.

Xavi: Vendimin për t'u larguar e mora në fillim të sezonit

Trajneri spanjoll Xavi Hernandez ka thënë se vendimin për tu larguar nga Barcelona e mori kohë me parë dhe jo tash për tash. "Vendimin për dorëheqjen time e kam marrë që një kohë të gjatë, puna e jonë nuk është vlerësuar mjaftueshëm. Singerisht, kam vendosur për t'u larguar qysh në fillim të sezonit", ka thënë Xavi. Në vend të tij, presidenti Joan Laporta e ëndërron njërin prej trajnerëve të mëdhenj, Jurgen Klopp apo Pep Guardiola.



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo



**NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA
OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyrueshme.
Prema Zakonu br. 03/L-222 Član 34, dole opisana imovina je konfiskovana od strane Prinudne naplate poreza zbog neplaćanja poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37. Imovina će se prodati putem aukcije zatvorenih ponuda kao što je regulisano "Zakon 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama" član 34 i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

Ofertat do të hapen: Për herë të parë me datën 19.02.2024 e Hene ne ora 11/ **Ponude će biti otvorene:** Prvi put 19.02.2024, Ponedjeljak u 11 časova
Vendi i shitjes: Zyra e Atk - Departamenti i mbledhjes së borxheve - Veternik (prapa Albi mall)/
Prodajno mesto: PAK kancelarije - Služba za naplatu - Veternik (iza Albi tržnog centra)

Përshkrimi i pasurisë: /Opis imovine

Subjekti/subjekt:

1 . Parcellë tokë Njesia kadastrale me numer parcelle P-73409076-01108-0 1131 m2
P-73409076-01107-0 3168 m2 P-73409076-01081-0 3920 m2 P-73409076-01082-0
1386 m2 posedim 1/1 te vendi i quajtur Skullan GRAÇANICE/
Zemljište, katastarska jedinica sa brojem parcele P-73409076-01108-0 1131 m2
P-73409076-01107-0 3168 m2 P-73409076-01081-0 3920 m2 P-73409076-01082-0
1386 m2 , privatna svojina površine, posed 1/1, koja se nalazi u Skullan-Gračanice, opština
Gracanice.
Çmimi fillestarë për parcelen: parcelle P-73409076-01108-0 1131 m2
P-73409076-01107-0 3168 m2 P-73409076-01081-0 3920 m2 P-73409076-01082-0
1386 m2 është 1000/€ për një ar /
Početna cena za parcelu: parcelle P-73409076-01108-0 1131 m2
P-73409076-01107-0 3168 m2 P-73409076-01081-0 3920 m2 P-73409076-01082-0
1386 m2 je 1000/€ za jedan ar

Kushtet e pjesëmarrjes: Kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancioni bankar) në shumën 10%(minimumi) të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.

Uslov učešća na aukciji; kada prodajemo nepokretnosti, je akontacija (bankarska garancija) u iznosu od 10% neizmirenih poreskih obaveza poreskog obveznika.

Paraqitja e Ofertave: Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

Dostavljanje ponuda: Sve ponude moraju jasno da identifikuju ponudenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu i broj bankovnog računa fizičkog ili pravnog lica koje podnosi ponudu. Ponude moraju biti primljene u zatvorenoj kovrti pre navedenog datuma i gorepomenutog vremena.

Kushtet e pagesës, Kërkohet pagese e tërësishme dhe e menjëhershme.

Uslovi plaćanja, potrebno je potpuno i blagovremeno plaćanje.

Pasuria mund të inspektohet: nga data 30.01.2024 deri me datën 15.02.2024 nga ora 09 deri 15
Nekretnina se moze razgledati: od datum 30.15.2024 do 15.02.2024 od 09 do 15 sati

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit të mbledhjes/Ime, prezime i službenik naplate:

Zyrtari: Ramadan Buzhala

Data / Datum:



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Financave – Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo



**NJOFTIM I SHITJES ME OFERTA TË MBYLLURA
OBAVEŠTENJE O PRODAJI SA ZATVORENIM PONUDAMA**

Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Neni 34, pasuria e përshkruar më poshtë është konfiskuar për mos pagesë të tatimit, nga Mbledhja e Detyrueshme.
Prema Zakonu br. 03/L-222 Član 34, dole opisana imovina je konfiskovana od strane Prinudne naplate poreza zbog neplaćanja poreza.

Pasuria do të shitet me ankand të ofertave të mbyllura sikurse është rregulluar me Ligjin 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat" dhe Udhëzimin administrativ nr. 15/2010, neni 37. Imovina će se prodati putem aukcije zatvorenih ponuda kao što je regulisano "Zakon 03/L-222 o poreskoj administraciji i procedurama" član 34 i Administrativno uputstvo br. 15/2010, član 37.

Ofertat do të hapen: Për herë të parë me datën 15.02.2024 e Ejtë ne ora 11/ **Ponude će biti otvorene:** Prvi put 15.02.2024, Cetvrtak u 11 časova
Vendi i shitjes: Zyra e Atk - Departamenti i mbledhjes së borxheve - Veternik (prapa Albi mall)/
Prodajno mesto: PAK kancelarije - Služba za naplatu - Veternik (iza Albi tržnog centra)

Përshkrimi i pasurisë: /Opis imovine

Subjekti/subjekt:

1 . Parcellë tokë Njesia kadastrale me numer parcelle P-72316002-02778-2 3110 m2
P-72316002-02740-8 490 m2 posedim 1/1 te vendi i quajtur Bellanice /Malisheve
Zemljište, katastarska jedinica sa brojem parcele P-72316002-02778-2 3110 m2
P-72316002-02740-8 490 m2 , privatna svojina površine, posed 1/1, koja se nalazi u bellanice,
opština Malisheve.
Çmimi fillestarë për parcelen: parcelle P-72316002-02778-2 3110 m2
P-72316002-02740-8 490 m2 është 1500/€ për një ar /
Početna cena za parcelu: parcelle P-72316002-02778-2 3110 m2
P-72316002-02740-8 490 m2 je 1000/€ za jedan ar

Kushtet e pjesëmarrjes: Kushti i pjesëmarrjes në ankand, kur kemi shitje të pasurisë së paluajtshme është paradhënia (garancioni bankar) në shumën 10%(minimumi) të detyrimeve tatimore të pa paguara të tatimpaguesit.

Uslov učešća na aukciji; kada prodajemo nepokretnosti, je akontacija (bankarska garancija) u iznosu od 10% neizmirenih poreskih obaveza poreskog obveznika.

Paraqitja e Ofertave: Të gjitha ofertat qartë duhet të identifikojnë pasurin e ofruar, shumën e ofertës, emrin, adresën dhe numrin e llogaris bankare të individit apo entitetit që paraqet ofertën, Ofertat duhet të pranohen në pliko (zarf) të mbyllur përpara datës dhe kohës të specifikuar më lartë.

Dostavljanje ponuda: Sve ponude moraju jasno da identifikuju ponudenu imovinu, iznos ponude, ime, adresu i broj bankovnog računa fizičkog ili pravnog lica koje podnosi ponudu. Ponude moraju biti primljene u zatvorenoj kovrti pre navedenog datuma i gorepomenutog vremena.

Kushtet e pagesës, Kërkohet pagese e tërësishme dhe e menjëhershme.

Uslovi plaćanja, potrebno je potpuno i blagovremeno plaćanje.

Pasuria mund të inspektohet: nga data 30.01.2024 deri me datën 14.02.2024 nga ora 09 deri 15
Nekretnina se moze razgledati: od datum 30.01.2024 do 14.02.2024 od 09 do 15 sati

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi i zyrtarit të mbledhjes/Ime, prezime i službenik naplate:

Zyrtari: Ramadan Buzhala

Data / Datum:





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 14 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 58 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Udhëheqës i Njësisë së Prokurimit
Numri i referencës:	UNP/ZKA/01-01/24
Grada:	ZKA-C3
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Hartimi i Planit vjetor të punës për vitin përkatës për Njësinë e Prokurimit;
- Hartimi i propozim planit vjetor të prokurimit dhe koordinimi i aktiviteteve më njësitë kërkuese për hartimin e planit;
- Menaxhimi i të gjitha aktiviteteve të prokurimit në përputhje me Planin vjetor të prokurimit publik dhe legjislacionin në fuqi;
- Hulumtimi i tregut me qëllim të realizimit të aktiviteteve të prokurimit në mënyrën më efikase dhe ekonomike;
- Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura dhe nxjerr urdhër-blerjet me kohë dhe sipas kushteve të kontratës;
- Përcakton metodologjinë e prokurimit për tender dhe procedurat e vlerësimit të çmimeve dhe ofron këshilla dhe asiston menaxhmentin në marrjen e vendimeve lidhur me çështjet kontestuese që mund të dalin në rastet e ekzekutimit të kontratave;
- Menaxhon me dosjet e prokurimit, duke përfshirë sistemin, klasifikimin dhe arkivimin e dokumentacionit sipas kërkesave ligjore dhe raporton rregullisht për punët e kryera dhe realizimin e detyrave;
- Bashkëpunimi me organet tjera kompetente për prokurimin publik – AQP dhe KRPP;
- Kryen detyra të tjera të përcaktuara nga Drejtori i Përgjithshëm.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Shtatë (7) vite përvojë pune profesionale që ndërlidhet me vendin e punës;
- Tre (3) vjet përvojë menaxheriale;
- Të jetë i certifikuar për prokurim publik sipas legjislacionit në fuqi.

Shkathësitë e kërkuara:

- Shkathësi të avansuara në menaxhim, organizim dhe caktim të objektivave;
- Njohuri të shkëlqyeshme për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi udhëheqëse, motivuese dhe komunikuese në menaxhim të performancës;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- Certifikatë sipas legjislacionit përkatës për prokurimin publik;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **15.02.2024 ora 16:00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalne Kancelarije Revizije Republike Kosova, kao i Člana 5, 6 i 7 Uredbe (NKR) 03/2021 o prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (izmenjeno i dopunjeno u Pravilniku (NKR) Br. 01/2023); vezano sa Članom 14 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu za regrutaciju za 2024. godine, kao i Odlukom Generalne revizorke br.58, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:	Rukovodioc Jedinice za nabavku
Referentni broj:	UNP/ZKA/01-01/24
Rang:	ZKA-C3
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Izrada godišnjeg plana rada za relevantnu godinu za Jedinicu nabavke;
- Izrada predloga godišnjeg plana nabavki i koordinacija aktivnosti sa zahtevnim jedinicama za izradu plana;
- Upravljanje svim aktivnostima nabavke u skladu sa godišnjim planom javnih nabavki i zakonima na snazi;
- Istraživanje tržišta u cilju obavljanja aktivnosti nabavke na najefikasniji i najekonomičniji način;
- Nadzor realizacije zaključenih ugovora i izdaje naloge za kupovinu na vreme i prema uslovima ugovora;
- Određuje metodologiju tenderske nabavke i procedure procene cena i daje savete i pomaže menadžmentu u donošenju odluka u vezi sa spornim pitanjima koja se mogu pojaviti u slučajevima izvršenja ugovora;
- Upravlja dosijeima nabavke, uključujući sistematizaciju, klasifikaciju i arhiviranje dokumentacije u skladu sa zakonskim zahtevima i redovno izveštava o obavljenom poslu i ispunjavanju zadataka;
- Saradnja sa drugim nadležnim organima za javne nabavke – CAN i RKJN;
- Obavlja i druge poslove koje odredi Generalni direktor.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma;
- Sedam (7) godina profesionalnog radnog iskustva koja se povezuje sa radnim mestom;
- Tri (3) godine rukovodećeg iskustva;
- Da bude sertifikovan za javne nabavke u skladu sa važećom zakonskom regulativom.

Potrebne veštine:

- Napredne veštine u upravljanju, organizaciji i postavljanju ciljeva;
- Odlično poznavanje efektivnog nadzora nad stručnim radom;
- Sposobnost zastupanja i zaštite interesa institucije i njenog integriteta;
- Liderske, motivacione i komunikacione veštine u upravljanju učinkom;
- Da poseduje dobre međuljudske veštine.

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljane Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju predati sledeća potrebna dokumenta:

- službeni formular NKR-a za aplikaciju;
- kopiju lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- Sertifikat prema određenom zakonodavstvu za javne nabavke;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Penzionog fonda);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne starije od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog funkcionera (*ako je primenljiva*);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenta dostavljena nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpuna će biti odbijena. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (*onlajn*) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije. Zadnji rok za podnošenje dokumentacije **15.02.2024. godine do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 01/2023); lidhur me nenin 33 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2024 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 58 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Zyrtar për Dizajnim të Raporteve dhe Publikime
Numri i referencës:	ZDRP/ZKA/02-01/24
Grada:	ZKA-B6
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punimi i dizajneve dhe punëve të tjera grafike/vizuale për krijimin e identitetit, konceptit dhe përçarjes së mesazhit apo simbolikës së raporteve të auditimit sipas përmbajtjes së tyre.
- Përgatit të gjitha projektet e dizajnit, që nga konceptimi deri te shpërndarja;
- Përcakton imazhet, fontet dhe formatet duke përdorur softuerin e dizajnit grafik;
- Hulumton ide për të paraqitur koncepte dhe për të reklamuar produktet / shërbimet në rrjetet sociale, webfaqe, televizione, gazeta etj;
- Përdor teknikën e tipografisë;
- Krijon versione të ndryshme të dizajneve, logove, koncepte për broshura, prezantime, flyer-a, fletpalosje etj;
- Asiston me realizimin dhe përgatitjen e videove dhe fotografive;
- Kryen edhe detyra të tjera, të ndërlidhura me dizajnin grafik dhe që paraqiten sipas nevojave dhe rasteve të caktuara.
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti në fushën e dizajnit grafik ose të ngjashme;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet certifikim nga fusha përkatëse.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e dizajnit grafik;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit).

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **15.02.2024 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o Generalnom Revizoru i Nacionalnoj Kancelariji Revizije Republike Kosova, kao i člana 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj Kancelariji Revizije (izmenjen i dopunjen Pravilnikom (NKR) br. 01/2023); vezano sa članom 33 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji Radnih Mesta; Godišnjeg plana zapošljavanja za 2024. godinu kao i Odluke Generalne Revizorke Br. 58 za popunjenje upražnjenog radnog mesta, Nacionalna Kancelarija Revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Položaj:	Službenik za dizajniranje izveštaja i publikacija
Broj reference:	ZDRP/ZKA/02-01/24
Grada:	ZKA-B6
Broj pozicija:	Jedno (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Izrada dizajna i drugih grafičkih/vizuelnih radova za kreiranje identiteta, koncepta i prenosa poruke ili simbolike revizorskih izveštaja prema njihovom sadržaju.
- Priprema svih projekata dizajna, od ideje do distribucije;
- Definiše slike, fontove i formate pomoću softvera za grafički dizajn;
- Istražuje ideje za predstavljanje konceptata i reklamiranje proizvoda/usluga na društvenim mrežama, veb stranicama, televiziji, novinama, itd.;
- Koristi tehnike tipografije;
- Kreira različite verzije dizajna, logotipa, konceptata za brošure, prezentacije, flajere, letke itd.;
- Pomaže u realizaciji i pripremi video zapisa i fotografija;
- Izvrši i druge zadatke, vezane za grafički dizajn i predstavljene prema specifičnim potrebama i slučajevima.
- Obavlja i druge zadatke po naređenju direktora departmana.

Osnovne kvalifikacije:

- Fakultetska diploma u oblasti grafičkog dizajna ili slično;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poželjna je sertifikacija iz relevantne oblasti.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti grafičkog dizajna;
- Veština komunikacije i planiranja rada;
- Istraživačke, analitičke, evaluativne veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost izvršavanja zadataka i poslova pod pritiskom;
- Računarske veštine programskih aplikacija (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate vrši se u skladu sa važećim zakonima.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za apliciranje;
- kopija lične karte Republike Kosova;
- dokazi o školskoj spremi (fakultetska diploma). Diplome dobijene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Dokaz o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom (ne starija od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (*ako je primenljiva*);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Dokumenti dostavljeni nakon roka neće se razmatrati, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (online) i na sajtu Nacionalne Kancelarije Revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **15.02.2024 do 16.00 časova**.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.



Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 4 dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, e duke u bazuar në vendimin me nr. 48/24 të datës 29.01.2024 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L "Përparimi" Sh. A me datë 30.01.2024 shpall:

KONKURS PUBLIK

I. Titulli: Mbikëqyrës i Terrenit për Sigurim Fizik

Numri i ekzekutuesve: 1

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Përgatitje universitare apo shkollim të mesëm

Përvoja e punës: Preferohet një (1) vit

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik

Koeficienti i pagës: Sipas aktit të brendshëm të ndërmarrjes

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës.
- Mban evidencën e shërbimit të sigurimit fizik - rojeve.
- Siguron dhe kontrollon përdorimin efektiv dhe ekonomik të aseteve të punës.
- Përgatitë raporte për punët që kryhen në kuadër të njesisë të sigurimit fizik - rojeve.
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik.
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

Kushtet e veçanta:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;

II. Titulli: Sigurim Fizik - roje

Numri i ekzekutuesve: 2

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit, nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla e Mesme apo fillore

Përvoja e punës: Preferohet gjashtë (6) muaj

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik

Koeficienti i pagës: 3.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Të jetë i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryejë detyrat e punës;
- Përkujdeset mbi sigurimin e objektit dhe pasurisë të organizatës, institucionit publik;
- Në rast të ndonjë rreziku lajmëron menjëherë personat kompetent;
- Sipas nevojës mund të caktohet edhe në lokacion tjetër për sigurim fizik;
- Është i obliguar të përdorë të gjitha mjetet e parapara të mbrojtjes në punë;
- Të jetë i aftë që të përdor mjetet kundër zjarrit;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Sigurimit Fizik;
- Kryen dhe punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes.

Kushtet e veçanta

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Shkathësi fizike, preferohet të ketë të përfunduar trajnime nga fusha e sigurisë;
- Preferohet të jetë i licencuar në fushën e sigurimit fizik;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës;
- Kopjen e letërnjoftimit;

III. Titulli: Pastrues i Zyrave dhe Objekteve

Numri i ekzekutuesve: 4

Orët e punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.

Përgatitja profesionale: Shkolla fillore

Përvoja e punës: Nuk kërkohet përvojë pune

I raporton: Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve

Koeficienti i pagës: 3.9

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vushtrri.;
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (Diploma të sillet e noterizuar);
- Ekstraktin e lindjes (Duhet të jetë origjinal);
- Dëshmitë për përvojën e punës (Nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin dhe ta dorëzojnë në zyrën e Arkivës të N.P.L "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtrri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe e-mail adresën. Shpallja është e hapur nga data 30.01.2024 deri me datë 13.02.2024 në ora 16:00.

N.P.L "Përparimi" Sh. A në Vushtrri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Për informata shtesë mund të kontaktoni në këtë nr. tel. 044 - 157 - 075.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Na osnovu članom 8, članom 10 pod st. 2.2, član 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službeni list Republike Kosovo, od dt. 01.12.2010, u vezi sa članom 4 i 5 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanje procedura konkursa na javnom sektoru koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu, koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo od dt. 31.10.2017, i na osnovu odluke br. 45/24 od godine 29.01.2024, Izvršnog direktora, N.P.L "Përparimi" Sh. A, dana 30.01.2024, objavljuje:

JAVNI KONKURS

I. Naslov: Nadzornik terena za fizičko obezbeđenje

Broj izvršilaca: 1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje postavljenja: Određeno vreme od jedne (1) godine, od kojih će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja.

Stručna sprema: Univerzitetsko obrazovanje ili srednja škola

Radno iskustvo: Poželjno jedna (1) godina

Izveštava: Vodu Odeljenja za Fizičko Obezbeđenje

Koeficijent plate: Prema internom aktu preduzeća

Opis zaduženja i odgovornosti posla:

- Sposoban je obavljati poslove sa punim radnim vremenom i bez ograničenja.
- Vodi evidenciju o uslugama fizičkog obezbeđenja i čuvara.
- Obezbeđuje i kontroliše efikasnu i ekonomičnu upotrebu radnih sredstava.
- Priprema izveštaje o poslovima koji se obavljaju u okviru odeljenja za fizičko obezbeđenje i čuvanje.
- Odgovoran je vodi odeljenja za fizičko obezbeđenje za obavljene poslove.
- Obavlja i druge poslove prema nalogu menadžmenta preduzeća.

Posebni uslovi:

- Državljanin Republike Kosovo;
- Fizička spremnost, poželjno je završiti obuke iz oblasti bezbednosti;
- Poželjno je da poseduje licencu u oblasti fizičkog obezbeđenja;

Prilozi uz prijavu:

- Aplikacioni formular N.P.L "Përparimi" Sh. A - Vučitrn.;
- Dokazi o obrazovanju (Diploma overena od strane notara);
- Izvod iz matične knjige rođenih (original);
- Dokazi o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte.

II. Naslov: Fizičko obezbeđenje

Broj izvršilaca:

Radno vreme: 40 sati nedeljn

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Srednja škola i Osnovna škola

Radno iskustvo: Najmanje šest (6) meseci

Izveštava: Rukovodioci jedinice za fizičko obezbeđenje;

Koeficijent plate: 3.9

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Biti sposoban da obavlja radne obaveze sa punim radnim vremenom i bez ograničenja;
- Stara se o bezbednosti objekta i imovine organizacije, javne ustanove;
- U slučaju bilo kakve opasnosti, odmah obavesti nadležna lica;
- Obavezno je koristiti sva predviđena sredstva zaštite na radu;
- Umeti da koristi opremu za gašenje požara;
- Po potrebi, možete takođe je raspoređen na drugu lokaciju radi fizičkog obezbeđenja;
- Za svoj rad odgovoran je rukovodilac jedinice fizičkog obezbeđenja.
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Posebni uslovi:

- Da ste državljanin Republike Kosovo;
- Fizičke sposobnosti, poželjno je imati završenu obuku iz oblasti fizičkog obezbeđenja Favorite;
- Prednost se daje osobama sa licencom u oblasti fizičke sigurnosti.

Uz prijavu je potrebno priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za N.P.L "Përparimi" Sh. A. ;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma se overava);
- Izvod iz rođenja (mora biti originalan);
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Kopija lične karte;
- Sudsko uvjerenje o krivičnoj prošlosti koje ne sem biti starije od šest (6) meseci.

III. Naslov: Čistač kancelarija i objekata

Broj izvršilaca:

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja

Stručna priprema: Osnovna škola

Radno iskustvo: Nije potrebno radno iskustvo

Izveštava: Rukovodioci jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata

Koeficijent plate: 3.9.

Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od pretpostavljenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i druge obaveze vezane za radno mesto a na osnovu zahteva pretpostavljenog
- Obavlja i druge poslove po nalogu uprave preduzeća;

Uz prijavu se mora priložiti sledeće:

- Obrazac prijave za N.P.L „Përparimi“ Š. A.;
- Dokaz o školskoj spremi (diploma mora biti overena);
- Izvod iz matične knjige rođenih (mora biti original);
- Dokaz o radnom iskustvu (ako postoji, nije obavezan);
- Kopija lične karte;

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zainteresovani kandidati mogu uzeti i predati prijavi formular u kancelariji Arhiva N.P.L. „Përparimi“ Š. A u gradu Vučitrnu, ul. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – filijala u Vučitrnu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kandidati koji konkurišu moraju da unesu tačnu adresu, kontakt telefon i e-mail adresu. Oglas je otvoren od 30.01.2024 do 13.02.2024 u 16:00 časova. N.P.L "Përparimi" Š. A u Vučitrnu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosovo. Za dodatne informacije možete se obratiti na ovaj broj telefona. 044 - 157 - 075.

Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene, a nepotpune prijave će biti odbijene.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjejpuneshpejite

RESTAURANT



SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

